



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

№ 21551 Prot

Tiranë, më 22 3 2017

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Specialist Hetues**, në Drejtorinë e Hetimit, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (4 vende)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat juridike.
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Avantazhe:

1. Të ketë eksperiencë pune në Administratën Shtetërore.
2. Njohja e një gjuhe të huaj.
3. Njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithsues për pozicionin:

- Zhvillon hetime të plota, objektive dhe të gjithanshme, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin Doganor, Kodin Penal dhe Kodin e Proçedures Penale, si dhe

hetimet e procedimeve penale të regjistruara pranë prokurorive të rretheve Gjyqësore ku janë atashuar për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal.

- Për çdo çështje penale konkrete hetimore, kryen hetime të deleguara nga Prokurori i çështjes penale.
- Kryen hetime me iniciativën e vet kur konstaton elementë të veprës penale gjatë kryerjes së hetimeve.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti;
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat;
8. Raport mjeko-ligjor;
9. Kartë identiteti;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 02.10.2017, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTORI PËRGJITHSHËM
Belinda Hoxhomi

